



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 91, datë 31.05.2019

PËR

**DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN NR. 53, DATË 25.06.2009 “PËR
TRAJTIMIN E DËMEVE QË MBULOHEN NGA KONTRATA E SIGURIMIT TË
DETYRUESHËM NË SEKTORIN E TRANSPORTIT”, E NDRYSHUAR**

Në bazë dhe për zbatim të pikës 2, të nenit 14, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar dhe nenit 13 të Ligjit nr. 10076 datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e disa ndryshimeve në Rregulloren “Për trajtimin e dëmeve që mbuloohen nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit”, miratuar me vendimin e Bordit nr. 53, datë 25.06.2009, e ndryshuar, si më poshtë:
 - i. Në nenin 3, shtohet pikat 2.1 dhe 2.2 me këtë përmbajtje:
 - 2.1 Për qëllim të këtij neni, data e marrjes së kërkesës për dëmshpërblim quhet data e depozitimit të kërkesës së bashku me dokumentacionin e plotë shoqëruar;
 - 2.2 Në rastet kur kërkesa e paraqitur nuk është e plotë, shoqëria e sigurimit i drejtohet paraqitësit të kërkesës me shkrim brenda 8 ditëve pas pranimit të kërkesës dhe kërkon plotësimin e dokumentacionit.
 - ii. Në nenin 6, pas germës c) shtohet paragrafi:

Në përfundim të trajtimit të kërkesës për dëmshpërblim:

- Në rast pranimi të kërkesës, shoqëria e sigurimit duhet të njoftojë palën e dëmtuar për masën e dëmshpërblimit të vlerësuar prej saj;
- Në rast refuzimi të kërkesës, shoqëria e sigurimit duhet të njoftojë me shkrim palën e dëmtuar për refuzimin dhe shkaqet ligjore, që çojnë në këtë refuzim.

Shoqëria e sigurimit do të kryejë pagesën e dëmshpërblimit brenda 14 ditëve pas përfundimit të afatit të trajtimit të dëmit dhe nënshkrimit të deklaratës së pranimit të dëmshpërblimit.

Në germën c/1, pas fjalës rekomande shtohet shprehja “ose në adresën elektronike apo me mesazh në numrin e telefonit në rastet kur këto jepen nga kërkuesi i dëmshpërblimit në formularin e kërkesës për dëmshpërblim”.

Në germën d), shprehja “germat a), b), c) të këtij neni, zëvendësohet me shprehjen “këtë nen”

iii. Në nenin 11, germa d), shprehja “i zyrës postare” zëvendësohet me shprehjen “siç përcaktohet në nenin 6, germa c/1”.

iv. Në nenin 17, pika 3, Tabela 2 “Shkalla e Humbjes së Aftësisë së Përhershme Për Punë”, zëvendësohet me Tabelën 2, bashkëngjitur këtij vendimi.

2. Ndryshimet në Rregulloren nr. 53, datë 25.06.2009 “Për trajtimin e dëmeve që mbulohen nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit”, e ndryshuar, të botohen në fletoren zyrtare.

3. Ngarkohen departamentet përkatëse për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi më 1 korrik 2019.

KRYETAR

Pajtim MELANI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Ervin KOÇI